REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 26.08.2025 Prot.42 (dyzetëedy)

Protokoll nr. 42

I mbajtur sot më datë 26.08.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.07.2025.
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2025";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
6.P-V "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030";
7.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e znj.L.R banuese në fshatin Podgoire NJ.A Vresahtas dhe z.R.Z banues në Fshatin.Vloçisht Nj.A Libonik, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
8. P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, "*Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025";*
9.P-V "Për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Maliq viti 2025";
10.P-V "Për miratimin e marrveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës të Shqipërisë (TALGA)";
11.P-V "Për miratimin e përditësimit të pjesshëm të listës së inventarit të pronave, të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.06.2010 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Gorë, të Qarkut të Korçës*";
12.Diskutime të tjera.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARI BASHKIA MALIQ

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Ronaldo Skënderi; Pranvera Begolli; Dritan Çami; Petrit Kupe; Idlir Limllari; Rovena Terolli; Fevri Sherifi; Danjela Ibrahim; Marinathi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Enida Avdolli; Klea Baçi; Floreta Zaçe; Kristina Malelli; Ilia Xhuti; Yllson Ibrahimllari; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Neresida Shindo; Marjeta Xhelollari; Server Xhuti;22 (njëzetëedy) këshilltarë

Mungesa: Gentiana Drabo; Plator Çollaku; Eriseld Jonusllari; Aramando Dautllari; Almir Elezi; Andonaq Risto; Lulëzim Hoxhaj; Dalina Krekas; Albina Xhejo; 9 (nëntë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjësi i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta;

Ornildi Demollari:Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë, i nderuar kryetari i bashkisë, të nderuar pjesëmarrës.Sikurse jemi njoftuar, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Maliqit.Besoj me materialet e mbledhjes, me njoftimin dhe materialet i keni marrë disa ditë përpara. Bëmë një verifikim të korumit, në sallë janë të pranishëm 21, realizohet korumi dhe mund të vijojmë me mbledhjen dhe me rendin e ditës.Para se të fillojmë duke marrë shkas nga një ngjarje e ditëve të fundit, ku njërs nha kolegeve tona të Këshillillt i humbi jetën djali , ju ftoj të gjitheve të mbajmë 1 minutë heshje. I përjeshtshëm kujtim i tij.Kjo ngjarje le të jetë si një këmbanë alarimi për të gjithë ne.Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës.

Kush është dakord ? 20 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 20 vota pro. Faleminderit.Tek rend i ditës kemi patur një mos kordrimin në lidhje me dëgjesën publike që ne zhvilluam, dëgjesa ishte planifikuar për në date 27, por do duhej të zhvillonim një mbledhje jashtë radhe, me sa na komunikoj Drejtoria e Shërbimit Social, ai material ishte në limited dhe duhej të miratohej.Na duhej të zhvillonim një mbledhje jashtë radhe për ta miratuar pastaj në Këshill dhe gjykuam që dëgjesën, ta zhvillonim nga data 27 në datën 25 dhe ë pas ta sillnim në Këshill.Keni të drejtë ne nuk mundëm tju njoftonim pak më pare, qëlloi dhe fund javë, por të gjithë aktorët që kishin inteters për dëgjesën, ishin njoftuar dhe sot e kemi sjellë në rendin e ditës.

Neresida Shindo:E di shumë mirë që jam Kryetare e Komisionit të Arsimit, ne ishim njoftuar për në datën 27 dhe na u tha dje në orën 10:00 për ndryshimin e datës, ne nuk mund të ishim prezent brenda 1 ore, nuk e di si mund të bëhet dëgjesa vetëm me drejtorë shkolle, por duhet të ketë dhe prindër.

Ornildi Demollari:Kishte dhe prindër.

Neresida Shindo: Kjo nuk ishte një çështje e zakonshme, por bëhet fjalë për Arsimin, bëhet fjalë për fëmijët tanë, për tu futur në rend dite dhe për tu kalaur me dikutim 1 orë.Mund të bënim dhe një mbledhje jashtë radhe, sepse është një diskutim që do vëmendje.Kam dhe disa paqartësira, lidhur me disa shifra të hedhura, por jo të detajuara, me zëra konkretë, ku do ndërhyet në shkolla, më duket diçka e përgjithshme.Ne nuk kemi nxënës.

Ornildi Demollari:Kur të shkojmë te pika do keni gjithë kohën e nevojshme për të diskutuar, duke qenë se nuk ishit në dëgjesë.Me Drejtorinë e Shërbimit Social kemi dakortësaur që materiali të zbardhet pas 4-5 ditësh, duke reflektuar të gjitha sygjerimet që ju keni, për atë material.

Neresida Shindo:Në rregull, faleminderit.

Ornildi Demollari:Materialin do e shtojmë te rendi i ditës, ndërkohë vijojmë me materialet e mbledhjes së kalaur, janë gjithësej tetë vendime, katër me karakter normative hde katër me karkter kolketiv, të cilët janë konfirmuar të gjithë.Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar, datës 21.07.2025.

Kush është dakord ? 18 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 18 vota pro.Faleminderit.Mbledhjes së këshillit i bashkohen dhe Këshilltarët z.Yllson Ibrahimllari dhe z.Ilia Xhuti, shkon në 22 numri i Këshllitarve të pranishëm në sallë.Kalojmë te pika katër e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2025"; Kemi ndonjë pyetje këtu? E kalojmë në votim?
Kush është dakord ? 22 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet. Me 22 vota pro.Faleminderit. Kalojmë te pika pesë e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";Kemi diçka këtu? Komisoni?
Ornildi Demollari:E kalojmë në votim pikën pesë?
Kush është dakord ? 22 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet.Me 22 vota pro.Faleminderit. Kalojmë te pika gjashtë e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030"; Kemi ndonjë pytje këtu?

Faslli Zholi:Përshëndetje të gjithve, për sa i përket pikës 6, Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030"; Ne zhvilluma dhe dëgjesën dhe unë isha prezent si Këshilltar, ne ramë dakord të miratohet, por kam dhe disa problme që unë i ngrita dhe atë ditë, dua të shihet me përparësi punësimi i zonjave grave dhe duhet parë ana e punësimit e grave dhe vajzave , kjo në administratë dhe në biznes privat.Këtë doja të shtoja, ne ramë të miratohet.

Ornildi Demollari:Falemiderit.Kryetar ke diçka këtu te Plani i Barazinë Gjinore ?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithve, janë disa pika që kanë të bëjnë me performancën e bashkisë, atë që unë shpjegova dhe në mbledhjen e parë, kanë të bëjnë me përfitmin e fondeve dirket, nga Ministria e Pushtetit Vendor, për efekt të performancës dhe një nga këto pika është dhe kjo.Ne kemi bërë një dëgjesë publike, ku kanë marrë pjesë shumë aktorë, Këshilltarë etj.Ku është diskutuar gjërësisht, unë nuk mendoj që Barazia Gjinore nënkupton që ne ti japim prioritet, grave, zonjave, por është ti shohim si të barabrtë me njëri tjetrin.Unë besoj se ne si institucion jemi para në këtë punë, po të shohim punësim, atë që ngriti Faslliu, por nuk është vetëm kjo punësimi, por është te respketi, duke e parë këtë më gjerë, te dhuna në familje, te problematika të tjera, dmth është një plan shumë i gjerë në konceptin tonë si institucion, por dhe i OJQ-ve që na mbështesin për këtë punë.Të cilat dua ti falenderoj.Besoj që Këshilli i Bashkisë me këtë miratim shton një elemnet plus, jo në letër, por duhet parë nen pas neni, hap pas hapi, me idenë që ne të përmbushim detyrime të mëdhenj logjore që BE i ka vendosur ndaj Pushtetit Vendor.Shumë falemiderit.

Ornildi Demollari:Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 22 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 22 vota pro.Faleminderit. Kalojmë te pika shtatë e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e znj.L.R banuese në fshatin Podgoire NJ.A Vreshtas dhe z.R.Z banues në Fshatin.Vloçisht Nj.A Libonik, banesat e të cilve u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";Kemi dhe një ndryshim këtu vlere, pasi shuma e akrduar nuk kishte mjaftuar dhë është bërë një ndryshim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Bëhet fjalë për dy familje në fshatin Strelcë, fonde nuk shtojmë, janë aq sa kishim parshikuar, por në momentin e parë ne i ksihim parashkuar ti mbulonim nga grandi që qeveria çel për këtë qëllim.Duke qenë se fondet nga grandi janë shpenzuar për raste të tjera, po i përballojmë përsëri nga fondet e Emergjencave Civile por të parshikuara me të ardhurat tona.Bëhet vetëm ky ndryshim në P-V që ju kemi sjellë, bëhet fjalë për vendimet 73 dhe 74 datë 30.06.2025.

Ornildi Demollari:Kemi ndonjë pyetje te pika 7? Për dy familjet.

Yllson Ibrahimllari:Mund të flasi Kryetari i Komisionit, ke një Komision që nak e listuar emrat që do mblidhej për këtë punë.Kryetari të flasi, ka një Komision këshilli për këtë çështje, që është z.Çami.

Ornildi Demollari:Drtian është zhvilluar mbledhja e Komisionit? Gjej rastin ta ritheksoj dhe njëherë jemi shumë dobët me punën e Komisioneve, përjashto dy tre Komisione, pastaj pjesa

tjetër jemi inekzistentë.Do ju rilutesha ti kushtoni pak më shumë vëmendje kësaj.Kryetar ke diçka tjetër këtu?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Bëhet fjalë për një rast zjarri dhe nuk besoj se ka vend për diskutim.Por unë mendoj që Sektori i Emergjencave Civile që ne kemi në bashki, ta rakordojë këtë punë dhe me Komisionin, nuk është ndonjë punë e madhe 10-15 minuta para mbledhjes dhe besoj se do zgjidhet dhe për tu njohur dhe të dhënë një vendimmarje.Kështu që do kërkoja mirkuptimin dhe të Këshillit, besoj se nuk do të ndodhë që mos realziohen këto punë.

Yllson Ibrahimllari:Është shumë thjeshtë, mund të përdorim dhe platformën ZOOM ose WhatApp, por të shkruhet dhe të dihet, rregullorja nuk na ndalon.Kush mban përgjegjësi dhi duket punë e tepërt në Këshill mund të japë dorëhqjen, nga të gjitha Komisionet kishe mundësi të më cakotje, me keni lenë te Komisioni i Emergjencave, duhet të mblidhet kaq, faleminderit.

Ornildi Demollari:Ju lutem e kalojmë në votim?

Kush është dakord me pikën shtatë ? 22 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 22 vota pro.Faleminderit. Kalojmë te pika tetë e rendit të ditës, P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, *"Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025";*

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po mund të shpjegoj diçka, se materiali në pamje të parë duket voluminoz, por ka vetëm tre momente për të diskutuar. Është rifutur në pozicion një këshilltar i kryetarit që është hequr herë e kaluar, nuk e di pse zyra juridike e ka parë në këtë linjë. Momenti i dytë ka të bëjë me ngritjen e zyrës së bashkëqeverisjes dhe performancës si detyrim ligjor.Nuk shtojnë punonjës, por bashkojmë IT, bashkojmë disa elementë të strukturës brenda, duke krijuar një zyrë bashkëqeverisje dhe performance, si detyrim ligjor për ligjin njëqind e nëntëmbëdhjetë dy mijë e katërmbëdhjetë për statusin e punësit civil dheduke i bashkëngjitur edhe të drejtën e informimit, po një ligj i detyrueshëm për ne, duke pozicionuar koordinatorë bashkëqeverisje, koordinatorë për të drejtën e informimit dhe koordinatorë për performancën dhe transparencën si detyrim ligjor. Ky është momenti i parë, momenti i dytë, më falni.Momenti i tretë ka të bëjë me ndarjen e Drejtorisë Prokurime Publike me Burimet Njerëzore.Tashmë sapo na ka ardhur një strukturë tip që do të jetë për të gjitha bashkitë sipas madhësive të themi, dhe janari do të jetë me një strukturë të tipizuar në të gjithë Shqipërinë na ka ardhur nga Ministria e Pushtetit Vendor, edhe lëvizjet që ne bëmë para të themi, një vit i shtatë-tetë muajsh për ngritjen e agjensive të tjera fillojnë të marrin një ndryshim të menjëhershëm dhe kjo drejtori, drejtoria e burimeve njerëzore, është shumë e rëndësishme për të pregatitur këtë material dhe janari apo dhjetori, të themi, hartimi, miratimi i buxhetit të vitit që vjen, kërkon një strukturë të tipizuar, siç na ka ardhur të themi plus minus, se nuk mund të jetë identike në çdo bashki. Por kjo na bëri detyrim t'i ndajmë.Nuk shtojmë punonjës as në drejtori e parë, as në

drejtori e dytë për këtë qëllim, por ndajmë ata që kemi brenda saj.Krijohet sektori i marrëdhënieve me publikun, sektori i teknologjisë së informacionit që ne i kemi, por i bashkojmë në këtë drejtori dhe sektori i burimeve njerëzore. Nuk ka shtesë punonjësish, nuk ka vlera financiare ekstra, kështu që për efekt të performancës dhe të mirëfunksionimit të strukturës së bashkisë dhe për t'i paraprirë asaj që thashë më lart, në hartimin e një strukture të tipizuar për të gjithë bashkinë në total, bëhet edhe kjo kërkesë pranë Këshillit të Bashkisë. Ndjesë do kërkoja për relacionin që u ka ardhur me vonesë është faji im.

Petrit Kupe: Këto shpjegime i kam bërë fjalë, këto shpjegime i kërkuan edhe në komision. Njëkohësisht kërkuam për mungesën e relacionit, mbasi ishte një P-V, që edhe ne që kemi marrë, kemi bërë diçka, nuk po e kuptonim. U shpjeguan arsyet qëllimi në kuadër të pregatitjes së strukturës së re të tipizuar. Ajo që ka e rëndësishme nuk ka shtesë të numrit të punonjësve, nuk ka as pakësime. Aty u diskutua për krijimin e këtyre, për shkëputjen edhe për mos pati konflikt të interesit të zyrës juridike me atë të prokurimeve. Njëkohësisht, nga komisioni u dha një sugjerim që të shikohet niveli i pagave të zyrës prokurimeve, mbasi është nga zyrat që ka më shumë ngarkesë dhe ka më shumë përgjegjësi edhe ligjore për punë që kryhet atje, kryetari tha që në këtë moment nuk mund t'i bëjmë, në vitin e ardhshëm do të bëhen diferencime sipas rëndësisë së vendit të punës, jo të emrave.Ne jemi dakord që të kalojë ky projektvendim, sepse ai projektvendimi tjetër ka të bëjë me pakësimin e një fondi nga një zë ura xharesh në kalim për projekte për të parashikuar investime në periudhën e ardhshme. Ne jemi okej.

Ornildi Demollari:Faleminderit.Kemi gjë tjetër? Po

Yllson Ibrahimllari:Të nderuar, ne jemi që jo vetëm të shtohen, por edhe t'i rriten rrogat, edhe t'bëhen funksional. Por do të doja se këto luhatjet shpesh shto këtë, pakso këtë, do të doja një farë stabiliteti, pavarësisht ndryshimeve të reja dhe për efekt të organizimeve që kryetari e tha shumë mirë. Por gjej rastin të shikoj dhe një gjë tjetër, se shpesh herë themi dhe këtu në këtë këshillë e kemi ngritur. Themi s'kemi materiale gati nga ekzekutivi dhe këshilli nuk mblidhet.Pastaj, mbas tre ditësh, lajmërohemi që kemi shumë materiale dhe na vijnë. Unë do të doja që në projektin e buxhetit që do të hartojmë të vitit që vjen, sepse besoj këto muaj janë të pakta.Të shikojmë dhe mundësinë e bërjes së një organigrame të Sekretariatit të Këshillit.Nuk mund t'i përballojë një njeri i vetëm të gjitha punët që ka këshilli. Ka nevojë qoftë me part-time, qoftë me njerëz. të involvuar, do një jurist, do një ekonomist, do diçka që neve, sepse ne kështu kthehemi, vijmë, i noterizojmë dhe ikim. Ky këshillë mblidhet për punët e veta dëgjon kryetarin e përgëzon për punët, merr materialet që ka detyrim ligjor t'i miratojë, po këshilli mblidhet edhe për punë të tjera jashtë ekzekutivit.Këshilli ka gamë më të gjerë të këtyre gjërave, që ta kthejmë funksional.Vërtetë, harmoninë e kemi, dashamirësinë për të ecur përpara.Pengesat të jemi një çik të kujdesshëm dhe kur i referohemi rregullores dhe ligjit dhe nenëve të ligjit, kryesisht, sepse përndryshe pastaj gjërat do t'i zgjidhim me gjykatë. Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, jam shumë dakord me propozimin, do të ketë parasysh nga ana jonë hartimin e buxhetit.

Ornildi Demollari:Faleminderit, kryetar. E kalojmë votim?
Kush është dakord me pikën tetë ? 22 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 22 vota pro.Faleminderit.Kalojmë te pika nëntë e rendit të ditës, Projektvendim për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Maliç për vitin dy mijë e njëzet e pesë. Për çfarë kryetar ke fjalën?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po e tha pak Petriti, është një fond një pikë dy milionë lekë, i cili ka tepruar nga riparimi i urave dhe ne duam ta përdorim për hartimin e, të synojmë të hartojmë tre projekte në varësi edhe të vlerave që do të ndodhin gjatë prokurimit. Një projekt do të jetë hartim projekti skema ujitëse me pika e rezervuarit të Leminotit. Është një kërkesë nga Ministria e Bujqësisë për të financuar një projekt që mos bëhet ujë ujitja me rrëmbim të themi, shpërdorim uji, por duam ta aplikojmë si projekt pilot në zonën Pirg-Leminot ujitjen me pika, me saraqineska të themi që t'i vijnë në krye të parcelës, edhe çdo fermer të ketë sahatin atje, edhe kundrejt një vlerë të themi minimale ta ketë mundësinë të kontrolluar për efekt të mirëmenaxhimit të ujit të parë, se nuk ka rëndësi shumë vlera financiare dhe e kemi urgjent, ndaj dhe e kemi sjellë. Projekti i dytë ka të bëjë me hartimin e një projekti për rrjetin e kanalizimeve të ujëra të zeza në fshatin Zvezdë, i cili në një farë mënyre sot, apo ujësjellësi i Korçës, po realizon një projekt për ujësjellësin e këtij fshati.Por problematika që aty lind do të ishte që të kish një projekt paralel për ujërat e zeza, edhe pse ka problem në kuptimin e mirëmenaxhimit. Ne duam të hartojmë një projekt dhe t'ia propozojmë që edhe ajo të jetë me dhomat e kantimit të tjera, që ujërat mos derdhen në fushë apo në kanalin fundor që e ka ky fshat. Nuk është si fshatrat e tjerë që uji mund ta thithë toka për efekt, po përbërjes që ajo ka ajo tokë e nxjerr në periferi dhe krijon shumë probleme.Dhe në që dhe projekti i tretë, në qoftë se do të arrijmë, pasi fondet janë të pakta të themi nga kursimet që mund të ndodhin, synojnë të hartojnë një projekt për sistemimin e lulishtes para bashkisë, për t'i dhënë një performancë më të mirë. Se duam t'i heqim me mure, me kangjella, me thera, ta nxjerrim diçka më të kohës, të themi edhe dhe me ujitje nga nëntoka, me një pus shpimi, etjera, etjera. Ky është qëllimi i tre projekteve që synojnë me këtë vlerë minimale, që është rreth një pikë dy milionë lekë.

Ornildi Demollari:Faleminderit, kemi ndonjë pyetje tjetër këtu?

Server Xhuti:Po, për ujësjellësinë e Zvezdës, e kam për këtë gjë. Faleminderit. Po ku parashikojnë të bëjnë këto ujërat e zeza?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ç'po flasim është po bëjmë projektin dhe ujësjellësi i Korçës. Gjasat mund të ndodhën menjëherë për efekt të mirëmenaxhimit të ujësjellësit.Të synojmë që ata do ta zbatojnë me fonde, sepse fondi është i konsiderueshëm, nuk flasim 5

milionë lekë apo 10 milionë lekë të reja, apo diçka vlerë më e madhe, do të shikojmë si do të rekordojmë me ta. Ne jemi gati edhe të bashkëfinancojmë si bashki, që atë ta realizojmë sa më parë.

Server Xhuti:Sepse ujrat e zeza janë origjinë, duhen bërë atje, është skandal me atë ujrat e zeza, të gjithë derdhen në kanal.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë s'kam një informacion të saktë, me sa di ish-ish-komunat, kanë bërë disa përpjekje, kanë bërë disa investime në fshatin Zvezdë për kanalet e ujërave të zeza. Kështu do të shikojmë si është ajo pjesë e bërë prej tyre. Do të shikoj nga specialistët e ujësjellësit të Korçës, se ata e menaxhojnë edhe ujësjellësin edhe kanalizimet. Për të bërë diçka që t'i rezistojë kohës dhe për mua e rëndësishme është që ne duhet të nxitojmë të kemi një projekt në dorë për të parë sa shkon vlera dhe t'i paraprijmë buxheteve të vitit që vjen, edhe të bashkisë, edhe të ujësjellësit të Korçës.Po, qëllimi është shumë i shumë i rëndësishëm dhe unë besoj duhet vlerësuar ajo çfarë po e arrijmë në kohë.

Server Xhuti:Është shumë urgjente.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të falenderoj.

Yllson Ibrahimllari:Në mbledhjen e kaluar, kur kryetari po fliste për shtimin në kabinet, kemi rënë dakord që i kemi dhënë aprovimin edhe për një supervizor ose ndjekës të punimeve.Besoj që ky ndjekësi i punimeve, tani që e ka marrë, e keni zgjedhur, do ta zgjidhni.Besoj që mund të gërshetohet edhe me drejtorinë e ujësjellësit, se ne kemi projekte që pambarimisht zgjatin afate, kemi shqetësime të komunitetit dhe kemi dhe mungesë të kontrollit të cilësisë. Pra, janë fonde që të bëjmë një punë që mos i kthehemi për së dyti. Unë para tre ditësh isha zezë për arsye që kalova në atë rrugë dhe pashë që nuk besoj që me ato markuçet që vadita arrat tonë të ketë cilësi për të çuar ujin e pishëm nëpër banesa, faleminderit.

Ornildi Demollari:E kalojmë votim?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund ta shpjegoj një moment, edhe pse bashkia nuk është, as financuesi, as zbatuesi, as të tjera, po një element duhet ta shpjegoj, tubot kryesore të ujësjellësit të Zvezdës janë nga më të mirat e mundshme. Unë kam ngritur një shqetësim mbas shqetësimit që banorët ngritën në këtë.Po patjetër për atë po them në lidhje me tubacionin që lidh linjën kryesore apo me familjarët, për ta parë si qëndron cilësia e tyre, pasi me ligj, ndjekësi i punimeve është mbikëqyrësi, që ka një licencë, është specialist për atë fushë dhe ndaj kemi kërkuar që ta shikojnë sa më dhe në qoftë se aty nuk është zbatuar kushtet teknike të kësaj pune, patjetër duhet të hiqen. Doja ta shpjegoja këtë moment, jo për ta hequr nga vetja, por për ta sqaruar edhe për komunitetin.

Server Xhuti: Të kemi ftuar Kryetar, nuk erdhe, edhe me burimin e ujit e kemi problem, ku do ta marrim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk është e vërtetë që më keni ftuar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë e ka, unë vij me punë e pa punë. Po për atë rast, nuk më keni ftuar se do të kisha mirësinë të vija të sqaroja këto që po e them këtu. Se nuk kam ça të fsheh ndonjë gjë, shpjegoj situatën që është një ujësjellës shumë e rëndësishme që po zbaton. Është një financim goxha i konsiderueshëm i sjellësit të Korçës me fonde të cilat nuk i kemi vënë ne në dispozicion, po i kanë vënë ata. Ata e financojnë, ata e menaxhojnë, ata do të japin zgjidhje deri në fund për të dhënë ujë njëzet e katër orë ujë brenda standardeve dhe të synojmë që të financojnë një projekt të dytë për ujërat e zeza dhe ne të fillojmë asfaltimin e rrugëve, edhe pse unë i kam parashikuar dy rrugë që këtë vit, por duhet ta shikojmë që ta balancojmë, që mos të fillojmë e shtrojmë rrugën sot e çajmë nesër për kanale të ndryshme.

Faslli Zholi: Doja të shtoja diçka, kryetar, e them mirë atë që duhet të ujësjellsi kryesor, i do tubat e mira.Familjarët, kjo është bërë gabim, mos ndodhi si fatin tonë që kemi në limoni, që është bërë copë copë rrugës që ke parë.Ajo është duhet parë se po u groposën, pastaj është me pasoja. Faleminderit.

Server Xhuti: Duhet të ketë një çik kontroll nga ana juaj, nga ana e bashkisë, sepse.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të ta shpjegoj dhe një moment, ne çojmë shqetësimin, patjetër vijmë takojmë banorët, e çojmë atë çfarë është. Por nuk jemi ne as financues, as zbatues. Janë institucione në këtë. Dua ta sqaroj këtë moment.

Ornildi Demollari:E kalojmë votim në pikën nëntë?

Kush është dakord me pikën nëntë ? 22 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 22 vota pro.Faleminderit.Kalojmë tek pika dhjetë e rendit të ditës. Projektvendim për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, pika dhjetë e rendit të ditës.Po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të sqaroj një moment, ne edhe në buxhetin e këtij viti kemi miratuar një fond për akademinë , të themi të trajnimit të punonjësve të administratës, të gjithë kemi nevojë të trajnojohen. Koha ecën. Nga mua i pari deri tek i fundit, po të themi në kuptimin e listës, ka nevojë të trajnohen dhe ka filluar një nisëm që do të jetë një structure, një akademi, e cila do të trajnojë punonjësit e pushtetit vendor, e financuar nga qeveria dhe nga

bashkitë. Mua më duket shumë interesante, nuk është ndonjë kosto e madhe për ne që e kemi futur në buxhet dhe minimalisht duhet kjo akt marrëveshje, kjo e drejtë që këshilli na jep për ta lidhur këtë akt marrëveshje me Ministrinë, Ministrin e Shtetit, buf shtetin vendor, që të bëjmë të mundur që kjo të marrë rrugën e zgjidhjes të ecë hap pas hapi. Kaq është me pak fjalë.

Ornildi Demollari:Faleminderit. Ka ndonjë pyetje?Po.

Yllson Ibrahimllari:Mesa di unë, është edhe një projekt i përbashkët i qeverisë Zviceriane dhe Suedeze për këtë gjë dhe është vënë re dhe vlen për të përgëzuar që një nga këshillat është dhe këshilli bashkiak i Maliqit. Është vënë re që më shumë kualitet ka në disa raste, them për bashki të vogla në territore më të ngushta, më pak afër infrastrukturës është vënë re që këshillat bashkiake janë më lartë sesa administrata dhe në të tilla raste është parë emergjente për t'i trajnuar pjesën e administratës që gjithmonë, për hir të vërtetës, përveç pjesës së punonjësve civilë, po e kam shumë të saktë dhe sapo të përgëzova. Në qoftë se do të marrësh dhe do bësh joint vençer dhe bashkëkryetare, e fillojmë.Po ta them, është shumë e saktë dhe është kështu dhe i kanë kërkuar bashkive të forta për t'i trajnuar bashkë me Zotin Shkëmbi dhe të tjerët, ju falenderoj. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Kemi gjë tjetër, kalojmë votim?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Duket sikur luvdoni veten tuaj, po megjithatë, po në qoftë se, ah po, kur të na, kur të na vijë? Jo, dakord, nuk mua më vjen, mua më vjen mirë. Unë shiko, unë normalisht, jo normalisht, jo se nuk e di, po edhe është e vërtetë se këta elementë që ka Këshilli i Bashkisë janë të përzgjedhurit e subjekteve politike dhe të komunitetit dhe nuk kanë marrë. Pa ofenduar asnjë, kanë përzgjedhur, as diskutohet dhe mua më vjen mirë dhe do më vijë shumë mirë në qoftë se vijnë fjalë të mira për të gjithë anëtarët e këshillit të bashkisë, nga institucione apo struktura të tjera.

Yllson Ibrahimllari:Nuk përmenda bashkinë që të drejtoni ju.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Por nuk besoj se mund të thonë këshilli ka notën dhjetë, administrata e ka gjashtë.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votim? Ju lutem.

Kush është dakord ? 21 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 21 vota pro.Faleminderit. Kalojmë tek pika njëmbëdhjetë, projektvendim për miratimin e përditësimit të pjesshëm të listës së inventarit të pronave të transferuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me numër pesëqind e njëzetë e katër, datë tridhjetë i gjashti dy mijë e dhjetëpër miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që

transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gorë, qarku Korçë.Është ai materiali që kishim një mbledhje më përpara, ramë dakord që të dëgjonim banorët. Vajtëm i dëgjuam banorët dhe pas kësaj jemi në këtë mbledhje. E kemi sjellë në mbledhjen e këshillit. Kemi që kush e do fjalën?Po.

Faslli Zholi: Faleminderit. Tashi në këtë pikë, bëmë edhe dëgjese në fshatin Velçan të Gorës, ku mora pjesë, të mirë ishte të kishte edhe këshilltarë të tjerë, se ne vendosëm bashkërisht që t'i dëgjonim atë ankimimin që bënë ata qytetarë që gjetëm ne atje, ishim me kryetarin edhe vetë specialistët e asaj fushe i dëgjuam atje një problem që u ngrit, që neve e pamë atje që atanë tërësi kërkonin që ligji shtatëmijë e pesëdhjetë e një, dikush kishte AMTP-në, dikush s'e kishte.Kjo duhet patur parasysh, meqë kemi edhe djalin këtu, dhe sipas rregullave ta shikojmë që ata të pajisen, se për taksat i paguajnë dhe nuk kishin çertiftikatën, dhe pastaj ata që ishin pronarë me shtatë mijë e pesëdhjetë e një, nuk kishin çertiftikatën e tokës. Që të mos kesh dokumente të paguash taksat, këta e kishin si pikë në qoftë se jam gabim në ide e para. Së dyti, ne i dëgjuam ata, tokën ata që bëhet llaf e kishin lënë me komisionin, që ta kishin për kullot si fshat.Vajtën deri në atë kufi dhe pjesa tjetër që kam, unë nuk jam kurrëqë edhe ajo pjesë që është aty kudo, jo vetëm atje, po të jetë pronar dikush. Aq më tepër që kur është institucioni, siç është bashkia, le të jetë po ç'al dua u kthem. Që e thamë edhe radhën e parë, që tokat t'i marrin ata, t'u afrohet ata që janë atje.Ata që janë atje, ose janë pa atë, pa atij fshati, pa asaj zone, dhe të ketë një garë të vërtetë, mos ketë një paracaktim, me një llaf të kërkohet këtu, që se unë nuk kam të bëj me emrin, por kam të bëj me rregullat dhe ligjin që e kërkon, që edhe ata të dalin nga kjo situatë të kënaqur sepse janë në pronën e tyre, dikush ka një lopë, dikush ka një dele, sepse me ato rrojnë janë pronat e tyre. Dhe mendoj që kjo të shikohet me përparësi. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit, Andi, kishe gjë? Kemi ndonjë pyetje këtu? Po, Server.

Server Xhuti: Me shtatë mijë e pesëqind e njëshin i kemi marrë, i kemi regjistruar edhe ne libri gjashtë.Vetëm zyra e regjistrimit s'na i ka regjistruar. Kemi disa prona të tjera, bëmë ta dimë.

Ornildi Demollari:Po, tjetër Yllson.

Yllson Ibrahimllari:Bëhet fjalë në në listën që është e para punës, është një VKM 2010 që ka ardhur dhe ne jemi shumë me vonesë për të regjistruar këto lista të pasurive, ju keni bërë një dëgjues publike, në cilën informacionin e keni të saktë, keni qenë vetë, keni dëgjuar. Unë nuk besoj që në një fshat malor të tillë dhe në ato konditat që u gjendën fshatrat një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetën, të rezultojë njëzet përqind e fondit të tokës të jetë tokë shtet. Unë besoj që këto gabime vijnë nga mospasqyrimi i mirë i hartave të kadastrës e tjera, por ky është opinioni im. Unë nuk bëhem pengesë për asnjë gjë. Problemi është që ka edhe një objeksion që e kanë sjellë një grup fshatarësh përsa i përket gjithë problematikës që ia janë ata me pronat. Ai fshat që ka një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetën, diskuton diku tek gjashtëqind e pesëdhjetë banorë dhe me njëqind e tridhjetë familje. Sot ka me përjashtim të pako gjë, nuk e di disa të tjerë, por e imja është më në fund e regjistruar.Ka njëqind e tridhjetë shtëpi pa formularin zero një. Të gjitha

banesat që ne japim, lekë për zjarret, për tërmetet, për shqetësimet që fundi i shtetit bën.Pra, këtu. Vihet re një e re, re e interesit. Kryetari është shumë dashamirës në këtë temë, edhe me zgjedhjen e Andit në këtë punë prej kohësh kontrollet, Kontrolli i lartë i shtetit e ka nxjerrë herë pas here regjistrimin e pasurive, që ne pastaj të marrim ato qeratë, ato mundësitë. Problemi qëndron që duhet parë mirë mos përplasim hartografinë. Ne nuk e kemi të drejtën, edhe ajo që thotë Fazlliu edhe bashkëbisedimin që bën Serveri, ne nuk e kemi të drejtën as të regjistrojmë, as të çregjistrojmë. Ne i drejtohemi. Në bazë të ligjit njëqind e tridhjetë e nëntë, njësh dyshi pika C thotë këshilli, ka të drejtën mbi ushtrimin, mbi pronësinë dhe është një e drejtë që nuk ia delegon askujt. Kur të vijnë Fazlli për t'i dhënë me qera, do kemi atë debatin e nevojshëm për procedurën.Tani thjesht po shkojmë te hipoteka për t'i regjistruar si tokë, pavarësisht pastaj interesave lokale, lajmërimeve, palajmërimeve sa të qarta.I nderuar zoti sekretar, dhe pasqyrimin e dëgjesave te faqja, siç e keni sipas rregullores, edhe për raste të tjera, këtu do të kishte vlerë. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë nuk di, tek serveri, më fal po. Jo, serveri është gjë tjetër.Ndoshta Andi mund të japë ndonjë përgjigje. Si mund të veprohet? Ça mund të bëhet?Se ndonjëherë kur hymë në anë teknike, edhe gabojmë, japim ndonjë mendje.Në vend të zgjidhim, prishim punë. Ajo çfarë unë kam shpjeguar herën e parë dhe i vazhdoj përsëri të qëndroj, është ne nuk po i marrim tokë askujt në një fshat, as kemi për ta bërë ndonjëherë këtë punë. Bile, jemi të prirur që tokat rreth e rrotull fshatit t'i marrin ata, t'i përdorin, t'i gjejnë mundësinë, o të marrin çertifikatën, siç u takon. Nuk e kam për ju, jo, e kam në përgjithësi. Po veçanërisht për Velçanin, tani me qenë se po flas. Kështu që ne që të saktësojmë këtë moment, nuk po bënim.një projektvendim, një vendimarrje që t'i merrnim tokën dikujt, t'ia jepnim dikujt tjetër. Jo, ne po e bënim për efekt regjistrimi. Në qoftë se jam i gabuar të më korrigjoi drejtori, për efekt që ajo ta përdorë dikush, o ata.Po kaq me pak fjalë.

Yllson Ibrahimllari:Edhe unë me pak fjalë po ta kthej përgjigjen.Ka qenë zoti një nga burrat e nderuar të kësaj krahine nga vij unë, Fidai Çaushllari, besoj të njëjtin konsideratë ndajmë bashkarisht, patjetër, që në komisionin kur i kanë regjistruar. Dhe krahasimisht me pasardhësit, është shumë më i nderuar po t'i marrim për t'i krahasuar. Flas lokalishte, jo më kështu në majë. Sepse pastaj s'po i hyjmë dëgjesës që na paskërkën fenë, që e paskërkan tërë problemin me mua, se në dy mijë, mo kryetar, në dy mijë e njëzet e treshin, se s'e mbaj mend as datën. Të paskërkam dashur të të prish mitingun, po ç'më duheshe? Unë isha këshilltari i parë, jo. Unë nuk jam një oracional në mendimet e mia.. I ka dëgjuar ai aty që e ka sjellë në makinë ai që iu dha kafetë ju Lozhan. Tani e lem se po mbaroj bisedën.

Ornildi Demollari:Nuk dëgjuam nga këto.

Yllson Ibrahimllari:I kemi të dëgjuara dhe mirë të dëgjojmë, të lutem zotëri, po si kam unë adetin time. Nuk jam nga ajo racë, unë i bëj hapur, jo mbas kurrizit. E thjeshtë fare. Unë besoj,

meqë ka që nga koha e Zotit Fidai, po të them, kur kam vajtur për të regjistruar, jam bërë në veçantë pesë komisione dhe përplasja ka qenë.Dua tokën e babait, dua këtë dhe të tjerët.Nuk është ndonjë fshat pa gërrindë ai në vetvete dhe kështu do të të vijë në qoftë se hipoteka ka vajtur. Andi e di që koordinatore për Velçanin është zonja Etleva Nako. Ka qenë në përditësim në dy mijë e nëntëmbëdhjetën, kur ka bërë përditësimin, dhe deklarata e hipotekës është. Velçani i ka dokumentat e ngatërruara.Nëse e ka të ngatërruara, ti dalim për zot. Ne si këshilltarë nuk mbajmë përgjegjësi për ngatërresat që vijnë nga hipoteka. Dakord, do t'i shikojmë me kujdes ato qeratë kur t'i sjellësh për qera.Faleminderit.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Përshëndetje, besoj që me këtë pikë jemi në rregull përsa i përket listës të trojeve. Unë e shpjegova pak radhën e parë, është një VKM 432e nëntëdhjetë e pestës.Katërmbëdhjetë i teti nëntëdhjetë e pesë, e cila tashmë është shfuqizuar, ajo bënte regjistrimin nëpërmjet formularit zero një dhe të gjithë pajiseshin me dokument pronësie. Për trojet në funksion të ndërtimit që kishin, meqënëse ajo VKM është shfuqizuar në 2020, ka dalë një VKM e re, e cila është VKM-ja 827. Me ndryshimin e vetëm që ka dhjetë mijë lekë të reja pagesë dhe një kohë zgjatje prej gjashtë muajsh dhe i bënë hipoteka nga fillimi, regjistrim fillestar dhe pajisje me dokument për të gjithë trojet në funksion të ndërtimit. Përsa i përket rastit tonë, besoj se të gjithë e kuptuam që bëhet fjalë dhe ne jemi në këto kushte, jemi një lloj si ata qytetarët atje.Po kërkojmë thjesht pronat që ka në pronësi dhe administrim bashkia.Në qoftë se ka një gjë për ta bërë sa më mirë, të gjithë së bashku unë do jemi i pari që të them.Gjej rastin domethënë jo për të për të për t'i bërë qejfin kot kryetarit, por gjej rastin që me ndërmjetësimin e tij aktualisht dhe tre fshatra të cilët ne i kishim të parregjistruar ka filluar regjistrimi fillestar. Të ndërgjegjësohen ata njerëz t'i qëndrojnë pronës në koka, që mos kemi këto problematika në të ardhmen. Dhe inshallah na jepet mundësia dhe kemi akses që dhe atje ku kemi problematika të theksuara ta rifutim përsëri për rimatje apo për ridigjitalizim. Faleminderit. përsa i përket, përsa i përket tokave të cilët, po të cilët i kanë në aktin e marrjes së tokës në pronësi.

Ornildi Demollari:Për Serverin,

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Përsa i përket, tokave të cilët, po të cilët i kanë në aktin e marrjes së tokës në pronësi, por nuk i kanë marrë fizikisht.Ligji njëzetë njëzetë, po në aktin e arrestuar të pronësisë janë të shënuara.Atëherë, po qe se ato janë në aktin e marrjes së tokës së pronësisë në tapi të shënuara.Bazuar në ligjin njëzetë njëzetë, automatikisht do bëhet regjistrimi dhe i atyre ngastrave një për një. Aktualisht, nuk ka filluar në të gjithë Shqipërinë të merret shpresojmë që të tani së shpejti të fillojnë edhe ata për implementimin e të gjithë sipërfaqeve që janë akt nga Maristoks Bronsi, se dhe ata prisnin një procedurë. Domethënë, sepse do bëhet rekordimi për çdo ngastër.

Ornildi Demollari:Po, faleminderit Andi, po i Ilir Po s'të dëgjon njeri atje.

Ornildi Demollari:Po Ilir, se s'është, s'është diskutim për mbledhjen e këshillit. Duhet, duhet të diskutoni atje në fshat. E kalojmë votimin? ju lutem, pikën njëmbëdhjetë.

Kush është dakord ? 20 vota pro
Kundër? 1 votë(Ilia Xhuti)
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 20 vota pro.Faleminderit

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po mund të shpjegoj diçka, në qoftë se, në qoftë se disa toka i ka zënë rruga, ju duhet të kërkoni shpronësim me dokumentacion.Më korrigjo, këtë po të them unë.

Ornildi Demollari:Aty ku është rrugë, do t'i ndryshohet, do t'i ndryshohet zëri. Nëse është rrugë, do shënohet rrugës. Hapë mikrofonin, Andi të lutem.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula:Më falni, atëherë unë di me dhjetëra raste që në rrugën Korçë-Pogradec të gjitha ngastrat që janë zënë nga zgjerimi i rrugës dhe ata që nuk kishin dokumentacion, e kisha rast të freskët dije, domethënë një qytetar që erdhi u ankua.I ka lekët të depozituara, sepse ato normalisht nuk ikin deri në momentin që qytetari të pajiset me dokument. Ato mbeten lekë të ngrira në bankë. Kur paraqit dokumentacionin, lëvrohet fondi që është përcaktuar për gjithësecilin.

Server Xhuti: Nga Zëmblaku deri te Baxhua janë dhënë paratë, nga Baxhua deri në doganën në Goricë, nuk janë dhënë.

Ornildi Demollari:E ke të qartë Ilir, se të ndërpreva të kërkoj ndjesë, po m'u duk.

Ilia Xhuti: E kam të qartë shumë mirë, jam shumë në brendësi të këtyre rasteve atje.Prandaj, se po mos i dija, nuk të thesha. Se i ka sjellë për vete dhe nuk ka pranuar firma, kur ka bërë rrugën, nuk ka pranuar asnjë dokumet.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Ilir, të lutem, unë nuk e di rastin konkret. Ma sillni ta shikoj dhe t'ju jap përgjigje. Shiko që mos, që mos e zgjatim këtë temën dhe të bëhemi pengesë për këshillin.Ideja është kjo në rast se ato toka nuk janë trajtuar si zë kadastral, që i përket ligjit shtatëmijë e pesëqind e një, automatikisht hipoteka nuk i ka regjistruar, sepse ligji shtatëmijë e pesëqind e një kishte detyrim ligjor të ndante vetëm tokën arë dhe çfarë përfshihen brenda tokës arë, vreshtë ose pemëtore. Në qoftë se ato kanë një zë të ndryshëm katastral nga kjo, mund të kenë mbetur pa regjistruar. Kështu që, me të mbaruar mbledhja e këshillit, mund të vish ta diskutojmë se është problem.: Është dakord pra në aktin e pronësisë.

Ornildi Demollari:Po Ecim, ju lutem, por kjo nuk do të thotë që kishte të drejtë. Edhe një herë, ju lutem, kalojmë në votim.

Kush është dakord ? 20 vota pro
Kundër? 1 votë(Ilia Xhuti)
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 20 vota pro. Miratohet, faleminderit. Tani do desha të kërkoj mirëkuptimin tuaj, të shtojmë këtë materialin që e preka pak më përpara është një projektvendim që na erdhi tani në fund, për ndryshimin e vendimeve numër shtatëdhjetë e tre dhe shtatëdhjetë e katër, datë një i shtati dy mijë e njëzet e pesë të Këshillit të Bashkisë, është ajo shtesa për në fshatin Strelcë, për dy banesat, kryetar mund të shpjegosh edhe një herë këtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E shpjegova pak më parë, po e shpjegoj përsëri, nuk po kërkojmë fonde ekstra, por mbulimi likuidimi i faturës do të bëhet jo vetëm nga fondet e emergjencave të buxhetit të shtetit që kemi bërë një pjesë.Por diferenca, përkatësisht vlerat shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë dhe katërqind e shtatëmbëdhjetë mijë, do të paguhen nga fondet e emergjencave, porme të ardhurat tona, se fonde të emergjencave janë dy kolona, edhe nga buxheti i shtetit, edhe nga buxheti jonë. Po e mbuloj me këtë, me vendimarrjen që këshilli e ka marrë në mbledhjen e datës një të shtatë.

Ornildi Demollari: A mund ta shtojmë në diskutim këtë material?Atëherë kemi ndonjë paqartësi tek kjo.
Kush është dakord ? 21 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 21 vota pro.Faleminderit. Tani vijmë tek dy materiale tek plani, plani i arsimit parauniversitar dhe plani i mbrojtjes sociale Bashkia Maliq, që ishin të lidhura me njëra-tjetrën. Të cilat menduam t'i shtonim tek kjo mbledhje për shkak të, sepse drejtoria e shërbimit

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund t'jua shpjegoj. Me pak fjalë, deri në datën 17 shtator, ne duhet të çojmë disa plane midis tyre dhe këto dyja, që të përfitojmë fonde ekstra për bashkinë tonë për efekt të performancës. Në qoftë se do të, ndoshta duhet të ishte bërë më parë. Nuk e di cili është moment tjetër, por për mos thirrur një mbledhje tjetër ekstra, vetëm për këtë punë menduam që këshilli t'ia prezantojmë. Janë bërë dëgjesa publike, ndjesë për atë që nuk është lajmëruar dhe nuk e di pse ka ndodhur kjo, se mund të ishte lajmëruar një ditë më parë. Ka mundësi, se unë pashë kish drejtor shkollash, kish thënë edhe s'ka pse të mos ndodhë, edhe kështu që, ajo ka të drejtën e saj të pyesë të bëjë edhe të arrijë në një marrëveshje të përbashkët për t'i kaluar.

Ornildi Demollari: Po faleminderit, kryetar Nersida. Tani ke gjithë kohën. Okej.

Yllson Ibrahimllari:Atëhrësh Nersida dhe ju mund të keni gjithë kohën, por ne nuk na detyroni dot që të shkelim rregulloren dhe ligjin.Kryetari i nderuar, zoti Topçiu. Ne mezi i bindim anëtarët tanë që të vijnë nëpër komisione, që të bëhen çik më shumë prezencën në autoritetin e tyre dhe për këtë arsye kemi filluar dhe po ecim çik më mirë. Besoj, jo vetëm për këtë gjë, ne jemi këtu në një bashki që fatkeqësisht vazhdojmë të kemi varfëri të madhe, që s'po e zhdukim dot me gjithë punët e mira që ju keni bërë.Kemi konflikte sociale me një me nxënës të shkollave dhe fatkeqësisht sapo kemi humbur njërin prej tyre.Kemi fatkeqësi familjare të drejtoreshës së arsimit, e cila nuk besoj që dije ka qenë këtu prezent në konsultim publik. Po pra, dakord, a po flasim? Të lutem, a ishte? Ishte gjë prezente? Jo.A ishte gjë prezente? Pra, ne kemi një gjë që po flasim për arsimin parashkollor parauniversitar dhe na mungonte edhe drejtoresha e arsimit të bashkisë. Na mungonte edhe kryetarja e komisionit të arsimit këtu dhe nuk e di se sa më të interesuar do kenë qenë grupet e tjera që kanë qenë të interesit. Nëse doni ta kalojmë, hajt ta kalojmë, bëjmë një nen dhe themi, ne do ta shkelim ligjin dhe rregulloren sa herë të kemi nevojë.Dakord, hajt ta shkelim. S'kemi asgjë, ne ju japim mandat për këtë gjë.Po, faleminderit. Po, këshilla.

Pranvera Begolli: Kryetar me leje. Për fat un dje si këshilltare, unë ndodha në zogjesën që u bë dhe pashë të gjithë problematikat që ngritën dhe i prekën të gjitha gjërat, e panë dhe planin e arsimit dhe problemi më kryesor, më fal. Problemi më kryesor është që këshilltarët të paktën të jenë të ndërgjegjësuar për t'i ndjekur gjërat dhe për të ardhur, ndoshta ishte përshpejtuar ajo gjë Danja, më fal, por unë pashë që drejtoreshat dhe me të drejtë të ngritën infrastrukturën në shkollë dhe mbi të gjitha kabinetet e shkollës. Sidomos kabinetin e IT, apo jo, siç thotë kështu?Sepse në një moment thamë, pse nxënësit tanë nuk vijnë te gjimnazi i Maliqit, po shkojnë të gjithë në Korçë, prindërit zgjedhin më të mirën, na thanë ata, sepse iu mungojnë kabinetet. Pra, bashkia tonë është të performoj, të kërkoj fonde për të krijuar atë çka u nevojitet të gjithë nxënësve tanë, që mos na ikin nëpër gjimnazet e Korçës . Ata janë të tërë me tërëkabinet e biologjie, kimie, ajtie, që është kryesore të tani teknologjia, megjithatë. Ndoshta ishte nxituar pak, por kur një drejtoreshë ka një fatkeqësi, nuk ka si të ndodhë këtu, kur ishin tërë drejtoreshat e arsimit.

Ornildi Demollari: Pranvera, faleminderit kryetar, ke fjalë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të sqaroj një moment, ju lutem. Qëllimi ishte në kuptimin e mirë të fjalës, nuk ishte për të bërë ndonjë të themi kashillëk ndaj dikujt, edhe as mendohet se nuk është që është një projekt vendim që duhet miratuar me hile Por në qoftë se ju e mendoni që s'duhet ta kalojmë sot dhe thërresim një mbledhje jashtë radhe, mbas një jave, për mua s'ka asnjë problem.S'ka asnjë problem, se neve qëllimi që dua të arrijmë është që këto dy plane t'i kemi të miratuar brenda datës pesëmbëdhjetë dhe për ne s'ka asnjë, apo brenda datës dhjetë, që të kemi mundësi të marrim ndër konfirmimin e prefekturës, që data shtatëmbëdhjetë, që është shtatëmbëdhjetë shtatori, të jemi si bashkitë e tjera dhe mos performojmë për dy arsye, se të tjerat i kemi të përmbushura dhe për këtë qëllim. Kurse për informacionet që ngre Pranvera.Dua t'i sqaroj që ne nuk bëjmë kabinetet kabinetet i çon Ministria e Arsimit. Nuk do ta hiq topin dhe kemi probleme të tjera, rikonstruksioni, mirëmbajtje, terene sportive, e tjera, tjera

që i mbulojmë me ngrohje, ujë, situatën, gjithë terren, edhe gjithë ambienteve shkollore, për të cilët jo se kemi bërë pak dhe duhet të bëjmë shumë, patjetër duhet të ngremë zemë tek ministria përkatëse, duhet të gjejmë donatoréky është moment tjetër, por situata nuk është se mungojnë laboratorët. Ne duhet të kërkojmë, apo ministria, drejtoria përkatëse, më shumë llogaridhënie. Ka një të drejtë kur thotë që ka dhe rënie të numrit të fëmijëve, edhe pse nuk jemi në ato shifra, mund të kërkova një informacion tani Maliqi ka rreth tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë nxënës dhe tetëqind e tridhjetë e nëntë fëmijë në kopshim parashkollor. Nuk ka rënie bile shkolla e mesme e Pirgut vitin që mbyllëm kishte shtesë të nxënësve, krahasimisht me shkollat e tjera. Janë fakte, argumente, por kjo s'do të thotë që ne duhet të punojmë nga njëri vit tek tjetri, që fëmijët, se mund të ndodhë që fëmijët shkojnë nga shkolla, nga një fshat, shkojnë në Korçë, se e kanë më afër, dhe kërkon prindërit, kërkon ta mësojë më mirë, t'i japë një. Se mendojnë që shkolla e Raqi Qerixhi, apo Themistokli Gërmenji, ka mësim më të mirë, ka kushte më të mira, ka laboratore më të mira, etjera, etjera. Apo nuk do në Korçë, po e do në Tiranë, dhe këto nuk do në Tiranë, po e do jashtë shtetit. Këto janë pjesë të prindërve dhe pjesë të asaj që nuk e ndalojnë dot, që është e hapur.S'kemi pse të detyrojmë as prindërit, as fëmijët.

Yllson Ibrahimllari:Në mbështetje të fjalës tënde, mendon që ka nevojë për psikolog klinik të grupeve të gatshme në këto rritje të shifrave të traumës që po pësojnë fëmijët të dy familjeve? Mendon që ka nevojë për më shumë hapësirë për after school, që njerëzit të vijnë.Liria për të zgjedhur dhe ne nuk i mbajmë dot njerëzit.shyqyr që kemi arritur një shprehje e Çërçillit, që ju e dini po aq mirë sa unë thiotë, ekonomia e tregut nuk është sistemi më i mirë i vlerave që kemi, por ky ka dalë mirë rezistusi dhe ne në lirinë nuk ia cënojmë askujt, por kjo nuk na bën ne të jemi më pak të përgjegjesh. Kemi dhunë familje, vrasje gruas, vetëvarje për arsye mjekësore, pasi pa diskutim kemi dy familje gati të ngujuara në pirg dhe në Zvirinë. A kemi nevojë ne të jemi më të më sensibilizues për këtë? Na thoni datën kur e doni mbledhjen jashtë radhëve, ne jemi gati. Unë, Vëlçan, nuk vajta, se kisha dy operacione, do t'i anulloj, po më ra në datën e kësaj. Vëmëndjen e ke, unë nuk mund të kaloj një gjë që të them.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do të shpjegoj edhe një moment, edhe pse Genta nuk ka qenë në të gjithë ,apo ndonjë drejtor shkolle të gjithë kanë qenë pjesë e grupit të punës, sepse ky material nuk mund të krijohesha nga ne. Kështu që ata kanë qenë pjesë, përveç komisionit, e cila është e drejtë e saj.Në qoftë se mendon që s'ka asnjë problem për mua. Se bëjmë, nuk e miratojmë sot.

Ornildi Demollari:Unë ndjej pendesë vetëm për komisionin.

Faslli Zholi: Unë mendoj, meqënëse kështu, jo për të shkreh, nuk jam kurrë për ta shkelur ligjin, jam pro ligjit, po meqënëse neve na kalon afati për të thithur ato para, mendoj që ta kalojmë këtë.

Yllson Ibrahimllari:Jo, nuk do ta kalojmë, se ne kemi diskutuar në kryesi që në datën njëzetë e nëntë do bëheshe mbledhja. Na u tha kemi disa gjëra me emergjencë, do ta bëjmë njëzetë e gjashtë, e bëjmë njëzetë e gjashtë, po më nesër thoni do ta bëjmë, sot nuk do ta kaloj pa thithur

mendimin e gjithë komunitetit. Po diskutoj si këshilltardhe është mirë që të dalim nëpër fshatra, andej nga kemi marrë mandatet, t'i diskutojmë gjithë hallet e arsimit.Pastaj të vijmë këtu e të flasim.

Ornildi Demollari: Faleminderit, Neresidatë lutem.

Neresida Shindo: Nuk mund të bisedojmë, ndoshta ka qenë i nxituar, ndoshta për fat të mirë unë u gjenda, ti s'u gjende. Kjo ndodhi dhe ne nuk e kthejmë dot pas dhe nuk duhet të ndodhte, nuk të bëhet me ndoshta kjo, ndoshta jemi nxituar edhe pikë për këtë, jemi të vetëdijshëm që nuk janë aq të përcipta gjërat.Kryetar, numri i nxënësve ka rënë dhe po flasim për cilësi e di shumë mirë ti dhe gjithë drejtorët, dhe unë prandaj desha të isha edhe në konsultimi, sepse kemi nxënës që ne i kemi regjistruar dhe nuk na vijnë asnjë ditë në mësim, vijnë tre herë në vit dhe kjo nuk është cilësi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, tani unë, unë për atë që fola pak më parë, flas me shkresa zyrtare.

Neresida Shindo: Jo, po flasim për konsultimin, sepse ishte konsultim. Kemi lëndë të tikut dhe informatikës që janë kthyer në orë të lira dhe as orë fiskulture, sepse nuk kanë kabinet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, jo, shiko të lutem, shiko tani, nxënësit e shkollës së mesme pirg janë fitues të olimpiadës së qarkut të Korçës kanë zënë vendet e para, jo vetëm të Pirgut, po edhe Pojani, gjithë shkollat e mesme të Maliqit, nga shkollat më të mira të qarkut të Korçës. Ka probleme, jam shumë dakord.Po mund të ketë probleme me internetin, me kabinetet, me të tjera.

Nersida Shindo: Me kabinetet, po për këtë është konsultimi për të biseduar me drejtorët dhe me instancat përkatëse.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani unë në parim po flas, se pastaj element për element.

Neresida Shindo: Mendoj që të lejmë një datë kur të jetë edhe drejtoresha e arsimit është e gatshme dhe të jemi brenda ligjit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Që ta kuptojmë, nuk kemi ne asnjë problem për këtë punë. I vetmi problem që ne e paraqitëm, bile kam ngulmuar unë, jo Ermanda, unë ia kam kërkuar Armandës ta fut me procedurë të përshpejtuar për efekt të bërjes gati për efekt të përfitimit të fondeve për bashkinë. Ndoshta hajde ta bëjmë një takim në ditën më të parë të mundshme, apo një mbledhje që mund të jetë, mund të jetë data shtatë, mund të jetë data ku di unë, data tre, mund të jetë data, nuk e di sa më parë e mundshme që ne të kemi mundësi, t'i lidhim, t'i çojmë prefekturë, të marrim konfirmimin, t'i çojmë në Tiranë.Janë dy plane, nuk besoj se kjo do të sjellë ndonjë ndryshim në mbledhjen e radhës.

Neresida Shindo: Po flasim për konsultimin, jo për, sepse ne nuk na u, na u tha që duhet tani.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk besoj, nuk besoj që do të bëhet një konsultim i dytë me grupet e interesit, se ajo është bërë. Mund të ndodhë që të bëhet një mbledhje e juaja e komisionit, unë këtë mendoj se nuk mund të thrritet prapë.

Neresida Shindo: Pavarësisht kësaj që ka ndodhur, ishte shumë i përshpejtuar, për këtë arsye po themi, nuk po them unë që nuk jam dakord të bëhet kjo dhe për të marrë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Në qoftë se mendoni që ne e shtyjmë mbledhjen vetëm për efekt të komisionit, ky është moment tjetër.

Pranvera Begolli: Kryetar, më fal një minutë, tashi dje ishin tërë aktorët dhe faktorët, tërë komuniteti, ishin drejroat e shkollave.

Neresida Shindo: Po ku u lajmëruam ata edhe në të banues në Maliq të jenë edhe punonjës bashkie, nuk mund të vishin gjysmë ore.Po ja lajmëruam më përpara, ajo brenda gjysmë ore.

Yllson Ibrahimllari:Unë shikoj më shumë pjesëmarrës të administratës sesa impenjim të këshilltarëve.Të lutem, biem dakord apo jo? Unë shikoj administratën më prezente në të gjitha konsultimet dhe bravo ju qoftë sesa prezencë të këshilltarëve që kanë marrë mandat prej komunitetit që të përfaqësojnë interesat e veta. Doni ta kalojmë, urdhëro mo, votën pro, por.Po të them dhe njëherë, mezi po i bindim këshilltarët të bëjnë detyrat. Të lutem, mos na i bëni si para që ende këto gjëra, që këshilltarët të demotivohen për zërin e tyre.

Ornildi Demollari: Më vjen keq pse e quan paraqende dhe pse mundoheni ta bëni?

Yllson Ibrahimllari:Sepse mendoj këtë gjë që sekretari i këshillit ka, ka dëshirën, disponibilitetin është djalë shumë i mirë që të marri të gjithë anëtarët e komisionit përkatës, kur bën konsultimin.

Ornildi Demollari: Kërkuam ndjesë për komisionin. Tani ju lutem, mos e bëni kaq dramatike, se nuk është.Po mos e thuaj kështu.

Yllson Ibrahimllari:Mos e jesh njësoj. Unë thonë, më fal se të vrava.

Ornildi Demollari: Jo, nuk është ashtu.Po, Ermanda, të lutem.

Faslli Zholi Unë mendoj, që të dalim, se unë nuk fola që po dua që mos humbasim ato fondet për t'i thithur ta bëjmë sa më parë komisionin të mblidhet, se të gjitha dhe unë jam dakord, nuk mblidhen prapë popullit sa herë duam ne, se bëjmë ne gabimin. Ky është mendimi im, se unë i

thashë pro, po unë do t'i nënshtrohem edhe grupit, edhe shumicës. Po, kjo është qlëmë,meqenëse po, jo, jo, nuk mund të bëjmë dëgjese tjetër, jo, të mblidhet komisioni, nëse duhet.

Yllson Ibrahimllari:Ta votojmë dhe të plotësohet me ato argumenta që do sjellë Komisioni, të sjelli relacioni Komisioni, por dëgjesa publike më ka çuar nëna mëhana për tarana nuk ka më. Okej, dakord.Sepse më fal një sekondë, të dy bashkë në mirëkuptim bëmë këtu për dëmet në frutikulturë.Unë nuk besoj që të gjithë janë të majtë ata që kanë mbjellë pemët edhe nuk erdhi asnjë djathtë këtu për të protestuar për atë që bashkëbiseduam bashkë. Dakord, ne e dimë që komuniteti nuk ka më interes, edhe ka vdekur.Mos i demotivoni dhe këshilltarët të bëjnë punën e tyre.

Ornildi Demollari: Më lejoni t'ju tërheq vëmendjen, se pesë ditë përpara ishte një dëgjues tjetër për një temë tjetër dhe asnjëri nga ju nuk erdhët.

Yllson Ibrahimllari:E di, po dëgjo, kujdes me intonacionin ti, se nuk më bëjnë programe pune mua në komision Nazmi Qosen ti mua mirë.

Ornildi Demollari: Ju lutem, tani mos e bëni kaq dramatike këtë, se pesë ditë përpara.

Yllson Ibrahimllari:Të lutem, herën e parë që do të shkelësh rregulloren, do të çojnë prokurori, herën e parë, ja po ta jap fjalë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kam një propozim, kam një propozim.

Yllson Ibrahimllari:Po të betohem ditën që e shkel rregulloren.Ti e di që unë s'të ndahem.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ta kalojmë në votim dhe ta shtojmë edhe propozimet konkrete.

Yllson Ibrahimllari:Hera e fundit që votoj kështu, se do ti, urdhëro.

Ornildi Demollari: Atëherë e kalojmë në votim, Ermanda, këto janë të dyja bashkë, apo jo? Ju desha të sqaroja diçka, që planet janë të ndryshme, para se të gjitha planet kanë lidhje me njëri-tjetrin dhe janë në varësi të njëri-tjetrit.Planet janë të ndryshme. dhe plani social vjen me ndryshimet përkatëse, duke iu paraprirë ndryshimeve që kanë vendosur ligje të ndryshme në pjesën e të ministrive përkatëse, por edhe meqënëse ne kemi hartuar dy plane të rinj, atëherë duke i rifreskuar edhe një herë informacion ose për objektivat që ne kishim vendosur te plani social, vijnë me disa ndryshime përsa i përketpërputhshmërisë së tij me planin social dhe me planin e arsimit dhe planin e barazisë gjinore, janë plane të ndryshme që duhen miratuar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Që të, që të sqarojë planin social, ne e kemi miratuar në dhjetor të dy mijë e shtatë. Që ta përfitojmë dhe këtë plan, i bëmë disa ndryshime me periudhën

që jemi, që ta futim dhe këtë për efekt të performancës së bashkisë. Prandaj, edhe duhet një votim edhe për këtë punë.

Ornildi Demollari:Për planin e arsimit parauniversitar. E kalojmë në votim me shtesat që do propozojë komisioni.

Neresida Shindo: Nildi, edhe një herë e kalojmë, po të mos bëhet normale që edhe një herë tjetër të ndodhë, ta neglizhojmë këtë kjo ishte ideja, nuk më ngelet hatri fare për kryetare komisioni.

Ornildi Demollari:Jemi shumë, jemi shumë dakord. Më vjen keq që e thekson dhe e rithekson, s'kemi ndonjë arsye që t'i bëjmë fshehur ata dhe kryetari. S'kemi ndonjë arsye për t'i bëjmë fshehur apo për t'i bërë, sepse bëhet rrugë. E kalojmë në votim planin e arsimit?

Kush është dakord ? 20 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 20 vota pro.Faleminderit. Miratohet me sygjerimet që do sjellë Komisioni.
Kishe gjë, Ermanda?
Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Jo, desha të sqaroj që ato do vazhdojnë të qëndrojnë në konsultim publik edhe për disa ditë në rrjetet sociale.Kështu që në qoftë se do ketë.edhe shqetësimet e tjera apo sugjerimet e tjera nga komuniteti janë të mirëpritur deri në zbardhjen e vendimit. E kalojmë në votim, atëherë kush është dakord me planin social?

Kundër, nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet, faleminderit.Tani jemi tek diskutime të tjera Po urdhëro, mbaruam po.Kemi dy zonja.

Qytatarja:Të zbatohet vendimi i Këshillit për hapjen e rrugës, në fshatin Zvarisht.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ja të të të të të shpjegoj diçka, të lutem, po nxirre, nxirre, dakord? Tani për prona, të lutem, ja më dëgjo, më dëgjo një moment ju pronat t'i kini e t'i gëzoni, nuk ia lëviz dot askush. Ka një institucion.Po s'ka lidhje, ka një institucion tjetër që është kadastra. edhe kur nuk vendosim ne dot një gjë, ka gjykata dhe ti po ke një vendim gjykate që kaq ke. Por aty ka një anomali, siç e kemi diskutuar. Ka një vendim të ish-Këshillit të Komunës Gorës, po kur ka qenë? Tani mos, nuk dua, nuk dua të, nuk dua të lutem o ti.Dakord mo dakord, po nuk dua të merrem as me emra, as me duhet të merrem me emra. Tani që t'ia shpjegoj këshillit, bëhet t'ia të lutem. Po, faleminderit. Tani të t'ia shpjegoj këshillit dhe ta diskutojmë edhe me Andin. Kur të dalim tani, ta diskutojmë me Andin. Po do ta diskutojmë kur të dalim me Andin, si është problemi. Po për t'ia shpjeguar këshillit, ta të bëj me një anomali. Jo, jo, jo, shpija, jo, rruga është një rrugë e cila ish-këshilli i komunës së mëparshme ka marrë një vendim që e ka mbyllur. Tani, në momentin tjetër, kam kërkuar që ne ta hapim rrugën. Po, , dhe problemi është me rrugën, jo me shpinë. Dakord, e dakord, e kam parë, e kam parë, po ujë drita mund të

paguhet, s'ka lidhje me rrugën, por e kanë me shpinë, po shpinë kush është? Do e shohim rastin me Andin.

Qyetarja:Kërkoj të paguhet qiraja e shtëpisë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të gjesh një shtëpi me kontartë qirja dhe ta paguan bashkia dhe dhe në një fshat tjetër.

Ornildi Demollari: Mirë faleminderit, kjo ishte mbledhja për sot, ditë të mbarë.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ